


KRYENGRITJA E KOSOVËS 1910 DHE DIPLOMACIA E FUQIVE TË
MËDHA

REZYME E PUNIMIT MASTER

NGA

BESARTA BERISHA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

SHTATOR, 2022

KRYENGRITJA E KOSOVËS 1910 DHE DIPLOMACIA E FUQIVE TË MËDHA

Mentor: Prof. Asoc. Dr. Nuri Bexheti

Kandidatja: Besarta Berisha

Qëllimi i këtij punimi shkencor është që të njihet çështja se si historiografia shqiptare i katrajtuar dhe cilësuar ngjarjet dhe proceset politike, shoqërore, kulturore nëpër të cilat kaloi popullsia e Kosovës. Studimi “KRYENGRITJA E KOSOVËS 1910 DHE DIPLOMACIA E FUQIVE TË MËDHA” ka për qëllim që përmes një objektive shkencore të shtjellojë një nga ngjarjetme shumë rëndesi për vendin tonë. Mbi zhvillime të ndryshme që e karakterizuan procesin e kryengritjes, kishte faktorë të ndryshëm që ndikuan që kjo kryengritje të organizohet, duke shpresuar që me këtë kryengritje do të realizoheshin kërkesat e tyre, dhe do të tregonin hapur që populli është i vendosur për t’i shprehur paknaqësit e shumëta që i rrethonin gjatë kësaj periudhe, por që kërkesat e tyre nuk merreshin parasysh me metoda të tjera, keshtu e shohin si zgjidhje të vetme që të ketë një kryengritje gjithëpërfshirëse në vend.

Padyshim, që në fillim të trajtimit të këtij disertacioni, i kam pasur parasysh të gjitha vështirësitë që mund t’i kem gjatë hulumtimit dhe arritjeve të rezultateve konkrete mbi këtë temë. Kjo nga fakti, që tema duhet të trajtohet në mënyrë aq të saktë dhe hulumtuese, që në fund ndonëse është i përfshirë në trajtim vetëm viti 1910, por që është i mbushur me plotë ngjarje e zhvillime si në Gadishullin Ballkanik e ekskluzivisht mbi territoret e të ardhmen e shtetit shqiptar. Mirëpo, ishte dëshira dhe vullneti im që të trajtojë këtë periudhë ngase, përkon me një etapë ku gjendja në trojet shqiptare ishte e rëndë dhe fatkeqësisht ende e padefinuar. Trajtimi i temës “Kryengritja e Kosovës 1910” përbën një pjesë të rëndësishme të historisë së shqiptarëve të Kosovës. Trajtimi i kësaj teme bëhet me qëllim që të njihemi sa më mirë me arsyet dhe rrjedhojat e kësaj kryengritje. Po ashtu, duhet të dimë për rolin që pati kjo kryengritje dhe si ndikoi në proceset e ardhshme që do të ndodhnin në trevat shqiptare. Në mënyrë që të jemi sa më të saktë në informatat që japim në këtë punim, kemi konsultuar literaturë të ndryshme duke filluar me autorë serioz të huaj dhe vendorë.

Punimi është i ndërtuar në tre krerë kryesorë të cilët janë të ndarë në nënkapituj të ndryshëm. Kreu i parë trajton përgjithësisht Vilajetin e Kosovës para fillimit të kryengritjes ku do të fillojm me: “Një vështrim i përmbledhur mbi gjendjen shoqëro-ekonomike të popullsisë së Kosovës para kryengritjes së vitit 1910” dhe do të ndahen në nënkapituj të ndryshëm që do t'i trajtojm sipas ngjarjeve. Qëndrimi Xhonturk ndaj Shqipetarve (1908-1909) është po ashtu shumë më rëndësi, që është shkaku kryesorë për paknaqësit dhe që erdhi deri tek kjo kryengritje. Çështje nga konteksti politik i kryengritjes së vitit 1910, Roli i Isa Boletinit në levizjen anti – xhonturke, si një patriot i vërtetë që deri në frymen e tij të fundit ishte kontributdhënës në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, ishte ai që në gjdo aspekt luftoj për vendin e tij, po ashtu edhe në Kryengritjen e Kosovës. Pastaj, në kreun e dytë trajtohet : “Rrjedha e ngjarjeve dhe zhvillimi i tyre”. Në kreun e dytë është më rëndësi të trajtohen rrjedhojat e kryengritjes, veprimet luftarake të cilat u zhvilluan me betejat të ndryshme. Si betejat e cilat kishte ide të kuart për zhvillimin e saj ishte Beteja e Kaçanikut, ku kjo betejë u shoqërua me vështërsi të ndryshme. Duhet dhe ja vlen të ceket edhe qëndresa e fundit dhe shuarja e Kryengritjes. Në kreun e tretë dhe të fundit diskutohet diplomacia që disa vende të ndryshme luajtën në raport me Kryengritjen e Kosovës. “Rëndësia dhe pasojat Ndërkombëtare” në këtë kreun e tretë dhe të fundit, nuk mund të kalohet pa u përmendur rëndësia e faktorëve ndërkombëtarë. Po ashtu në nënkapitujt, nuk duhet të mbetet pa u përmendur Diplomacia e fqinjëve ballkanikë ndaj Kryengritjes shqiptare të 1910-ës, që kishte ndikimet e veta, por edhe më e rëndësishme edhe Diplomacia e Fuqive të Mëdha ndaj Kryengritjes. Synimi për unë e kam marrë këtë temë për trajtim janë rrethanat në të cilat do të zhvillohet kjo kryengritje dhe marrëdhëniet shqiptaro- osmane pas shtypjes së kryengritjes së vitit 1909 me dhunë nga ana e osmanëve.

Në këtë studim për të arritur në një konkludim, do të përdoren metoda të ndryshme shkencore të studimit, siç është metoda e analizës, duke përdorur këtë metodë do të pasqyroj në mënyrë të përgjithshme gjendjen në atë kontekst kohor dhe pastaj në mënyrë të veçantë të ndaj mendimin tim dhe të autorëve tjerë lidhur me një çështje të caktuar. Do të përdoren edhe metodat e tjera të kërkimit shkencor, sikurse: përshkrimi, hulumtimi dhe krahasimi. Pas përfundimit të studimit, në fund fare, në mënyrë të përgjithshme do të jepet edhe një përfundim në lidhje me këto ngjarje. Punimi mbyllet me burimet arkivore dhe literaturën e gjerë të cilën e kemi shfrytëzuar, revistat shkencore, shtypin e kohës si dhe burime të ndryshme të shfrytëzuara nga

interneti. Gjatë punimit të diplomës kam shfrytëzuar literaturën adekuate për këtë temë, librat në të cilat është trajtuar ajo, të cilat janë të shkruara si nga autorë vendorë dhe të huaj.